



Prishtinë, 03 tetor 2014
Kodi i ZRRE-së: V_655_2014

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 14 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Kërkesën e KOSTT për aprovimin e amendamentimit të Rregullave të Ankandit për Alokimin e kapaciteteve interkonektive të Evropës Juglindore (EJL) të datës 05 shtator 2014,

në seancën e mbajtur me datë 03 tetor 2014, nxori këtë:

V E N D I M

- I **Aprovohen amendamentimet në Rregullat e Ankandit për Alokimin e kapaciteteve interkonektive të EJL**

Arsyetim

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 05 shtator 2014 ka pranuar kërkesën e KOSTT për aprovimin e amendamentimit të Rregullave të Ankandit për Alokimin e kapaciteteve interkonektive të EJL.

Dokumenti është miratuar nga Bordi i Drejtorëve të PTC CAO SEE (*Project Team Company Coordinated Auction Office in the South East Europe*).

Fillimisht, ZRRE ka aprovuar dokumentin me datë 12 mars 2014 me vendimin V_615_2014. Dokumenti është rishikuar nga grupi punues që përbëhet nga përfaqësues të TSO-ve pjesëmarrëse. Çështjet e diskutueshme rreth tabelës në Aneksin 3 që kishin mbetur të paaprovuara tashmë janë tejkaluar dhe janë bërë edhe disa përmirësime në përmbajtje duke u kompletuar si dokument final.

ZRRE pas vlerësimit të dokumentit dhe bazuar në kërkesën e KOSTT, konsideron se dokumenti me ndryshimet e bëra, i plotëson kriteret e nevojshme për të qenë si rregull bazë për kryerjen e aktivitetit të Ankandit për Alokimin e kapaciteteve për rajonin e përfshirë në dokument, prandaj bënë **Aprovimin e Rregullave të Ankandit për Alokimin e kapaciteteve interkonektive të EJL të amendamentuara.**


- II Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

- III Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimt të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.


Bordi i ZRRE-së



Enver Halimi, kryesues



Merita Kostari, anëtare



Krenar Bujupi, anëtar